

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik (laborant) me kohë të plotë pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave në Departamentin e Shkencave të Tokës si më poshtë:

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik (laborant) në pranë Departamentit të Shkencave të Tokës në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor + Master i Shkencave) në degët Kimi e përgjithshme, Kimi industriale ose Kimi ushqimore.
2. Të ketë përvojë paraprake mbi 3 vite në një laborator kimie.
3. Të zotërojnë njohuri praktike të përdorimit të pajisjeve laboratorike të lartpërmendura dhe metodave standarde të kimisë analitike.
4. Aftësi për të ndjekur me përpikmëri udhëzimet dhe procedurat standarde të punës.
5. Njohuri në fushën e sigurisë, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe higjenës në laborator.
6. Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i/ e aftë për të punuar në grup.
7. Njohuri të mira kompjuterike.
8. Njohuri të mira të gjuhës angleze.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 16.09.2026 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.